



BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

17.03.2021

Procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit

TEZA 3

ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)

1. Në bazë të Ligjit 10091 'Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar', audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që kryen auditimin ligjor të njësive ekonomike me interes publik, brenda tre muajve pas mbylljes së vitit financiar, publikon në faqen zyrtare të internetit një raport për transparencën.

Cili nga alternativat e mëposhtme nuk përbën element të raportit për transparencën:

- a. Përshkrimi i strukturës ligjore dhe i pronësisë;
- b. Përshkrimi i strukturës drejtuese të shoqërisë së auditimit;
- c. Përshkrimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë së auditimit;
- d. Lista e njësive ekonomike me interes publik, për të cilat është kryer auditimi ligjor gjatë vitit të fundit nga shoqëria e auditimit;
- e. Deklaratat e praktikave të pavarësisë së shoqërisë audituese;
- f. Deklarata e përgjegjësive profesionale të shoqërisë audituese;
- g. Deklarata për politikën e ndjekur nga shoqëria audituese, për kualifikimin e vijueshëm profesional të audituesve ligjorë;
- h. Informacion në lidhje me bazat për shpërblimin e ortakëve të angazhimit.

Përgjigja e saktë është alternativa F

2. Sipas SNKC 1, shoqëria e auditimit duhet të vendosë dhe të zbatojë një sistem të kontrollit të cilësisë, që përfshin politikat dhe procedurat që trajtojnë secilin nga elementet e mëposhtëm, përveç:

- a. Përgjegjësinë e lidershipit për garantimin e cilësisë brenda firmës;
- b. Kërkesat përkatëse etike;
- c. Pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe të angazhimeve specifike;
- d. Burimet njerëzore;
- e. Dokumentimin e sistemit të kontrollit të cilësisë;
- f. Performancën e angazhimit;
- g. Monitorimin;
- h. Alternativat f dhe g.

Përgjigja e saktë është alternativa E

3. Përshkrimi i çështjeve kryesore të auditimit në seksionin e Çështjeve Kryesore të Auditimit në raportin e audituesit do të trajtojë sa vijon:

- a. Pse çështja ka qenë konsideruar të jetë e një rëndësie të madhe në auditim.
- b. Si është trajtuar çështja në auditim.
- c. Konkluzionet e trajtimit të çështjes nga procedurat e auditimit.
- d. Një opinion mbi secilën çështje kryesore të auditimit.
- e. Të gjitha çështjet që kanë çuar në dhënie të një opinioni të modifikuar.
- f. Të gjitha më lart.
- g. a dhe b.
- h. a, c dhe e.

Përgjigja e saktë është alternativa G

4. Ligji nr 10091 date 5/3/2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te audituesit ligjor dhe te kontabilistit te miratuar” parashikon se profesioni kontabel organizohet nga:

- a. nje organizate profesionale per audituesit ligjor
- b. nje organizate profesionale per audituesit ligjor dhe nje organizate profesionale per kontabilist te miratuar
- c. nje organizate profesionale per audituesit ligjor dhe dy organizata profesionale per kontabilist te miratuar
- d. nje organizate profesionale per audituesit ligjor dhe tre organizata profesionale per kontabilist te miratuar
- e. nje organizate profesionale per audituesit ligjor dhe nje numer i papercaktuar i organizatave profesionale per kontabilist te miratuar
- f. nje numer i papercaktuar i organizatave profesionale per audituesit ligjor dhe nje numer i papercaktuar i organizatave profesionale per kontabilist te miratuar
- g. nje numer i papercaktuar i organizatave profesionale per audituesit ligjor dhe nje organizate profesionale per kontabilist te miratuar
- h. nje numer i papercaktuar i organizatave profesionale per audituesit ligjor dhe dy organizata profesionale per kontabilist te miratuar

Përgjigja e saktë është alternativa E

5. “Bazuar në rishikimin tonë, asgjë nuk na ka ardhur në vëmendje që na shtyn të besojmë se këto pasqyra financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pasqyren e pozicionit financiar më 31 dhjetor 20x1, pasqyren e performances se saj financiare dhe pasqyren e flukseve të mjeteve monetari për vitin që përfundoi, në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar”.

Paragrafi me sipër është:

- a. nje opinion auditimi
- b. nje opinion auditimi që jep siguri negative
- c. nje opinion auditimi që jep siguri të arsyeshme
- d. nje opinion auditimi që jep siguri të kufizuar
- e. nje konkluzion
- f. nje konkluzion që jep siguri negative

- g. nje konkluzion qe jep siguri te arsyeshme
- h. nje konkluzion qe jep siguri te kufizuar

Përgjigja e saktë është alternativa H

6. Jepen standardet e meposhtme:

- i. Standardet Nderkombetare te Auditimit
- ii. Standardet Nderkombetare te Kontrollit te Cilesise
- iii. Standardet Nderkombetare per sherbimet e lidhura
- iv. Standardet Nderkombetare per angazhimet e sigurise
- v. Standardet Nderkombetare per angazhimet e lidhura

Cilet nga standardet e meposhtme jane standarde angazhimi qe botohen nga IAASB:

- a) i, ii, iii, iv, v
- b) i, ii, iii, iv,
- c) i, ii, iii
- d) i, iii, iv, v
- e) i, iii, iv
- f) ii, iii, iv, v
- g) ii, iii, iv
- h) iii, iv, v

Përgjigja e saktë është alternativa D

7. Cili/cilet jane elementet e angazhimeve te sigurise?

- a) Kriteret
- b) Evidencat
- c) Raporti
- d) Marredhenia me palen e trete
- e) Lenda
- f) Asnje nga alternativat me siper
- g) a,b,c,d dhe e
- h) b,c dhe d

Përgjigja e saktë është alternativa G

8. Jepen rreziqet e meposhtme te biznesit:

- i. Vijimesia
- ii. Katastrofat fizike
- iii. Prishja e sistemit te kontabilitetit
- iv. Humbja e personelit kyc
- v. Rreziku i krdise
- vi. Thyerja e legjislacionit
- vii. Rreziku i kursit te kembimit
- viii. Manaxhimi i dobet i markes
- ix. Ceshkje mjedisore

Cili/cilet prej rreziqeve te mesipermeve perbejne rrezik financiar

- a. i, ii, iii, iv
- b. v,vi,vii,ix
- c. ii,iv,vi,viii
- d. i,iii,v,ix
- e. ii,iv,vi,ix
- f. i,iii,v,vii
- g. iii,v,vii,ix
- h. i,iii,vi,viii

Përgjigja e saktë është alternativa D

9. Në cilat angazhime do të aplikohet SNAR 2400 Angazhimet për Rishikimin e Pasqyrave Financiare:

- a. Rishikimin e pasqyrave financiare për cdo tremujor
- b. Rishikimin e pasqyrave financiare kur përgatitës i pasqyrave financiare është një auditues tjetër ligjor
- c. Rishikimin e pasqyrave financiare të ndërmjetme nga audituesi ligjor i shoqërisë
- d. Rishikimin e pasqyrave financiare të ndërmjetme nga një auditues ligjor që nuk është audituesi ligjor i shoqërisë
- e. Rishikimin e pasqyrave financiare 6 mujore
- f. Rishikimin e pasqyrave financiare të konsoliduara
- g. Rishikimin e pasqyrave financiare paraprake
- h. Rishikimin e pasqyrave financiare të audituara nga një tjetër auditues ligjor

Përgjigja e saktë është alternativa D

10. Nëse në kushtet e një angazhimi sipas SNAS 3402 Raportet e Sigurisë mbi Kontrollin e një Organizate Shërbimi; ju si profesionist vendosni të mbështeteni mbi punën e kryer nga audituesi i brendshëm i shoqërisë; atëherë cili nga pohimet e mëposhtme nuk është relevant për vendimin tuaj:

- a. Puna e audituesit të brendshëm është profesionale
- b. Audituesi i brendshëm ka aftësitë teknike të nevojshme
- c. Audituesi i brendshëm ka marrë trajnimet e nevojshme
- d. Audituesi i brendshëm ka arritur në konkluzione si pasojë e mbledhjes së evidencës së mjaftueshme
- e. Audituesi i brendshëm ka arritur në konkluzione që janë konsistente me punën e kryer
- f. Audituesi i brendshëm ka konkluduar në një raport me gjetje thelbësore
- g. Puna e audituesit të brendshëm ka patur supervizimin e nevojshëm
- h. Puna e audituesit të brendshëm ka patur rishikimin e kërkuar

Përgjigja e saktë është alternativa F

PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)

1. Ju jeni një ortak auditimi në AV Auditing Shpk, një shoqëri auditimi, e cila sapo është emëruar si audituesi i ri i Senega Shpk për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020. Nëse AV Auditing do të pranojë angazhimin, kjo do të ishte hera e parë që Senega Shpk do të auditohet nga ana e firmës tuaj. Shoqëria Senega Shpk dhe drejtuesit e saj nuk janë të njohur për firmën tuaj të auditimit. Ju jeni gati për të pranuar këtë angazhim por fillimisht duhet të merrni informacion mbi klientin tuaj dhe integritetin e tij.

Kërkohet:

Shpjegoni shkurtimisht 3 (tre) burimet e informacionit për klientin e ri sipas kërkesave të SNKC1.

Zgjidhje:

Sipas SNKC 1, përpara se të ndërmarrë një angazhim për një klient të ri, shoqëria e auditimit duhet të marrë informacion mbi klientin si dhe të vlerësojë integritetin e tij.

Meqënëse AV Auditing Shpk po konsideron të ndërmarrë këtë angazhim dhe ky do të përbënte një auditim për herë të parë për klientin nga ana e firmës tuaj në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, atëherë AV Auditing Shpk, duhet të marrë informacion nga **tre** burimet e mëposhtme të listuara nga SNKC 1:

- i) Komunikimet me audituesin ekzistues ose të mëparshëm, ose ofruesit e shërbimeve profesionale kontabël për klientin, në përputhje me kërkesat përkatëse etike të Kodit të BSNEK, dhe diskutimet me palët e tjera të treta. **(2 pikë)**
- ii) Kërkimet e informacioneve nga personeli tjetër i firmës ose nga palët e treta të tilla si bankierët, këshilltarët ligjorë dhe kolegët e sektorit. **(1 pikë)**
- iii) Kërkimet historike mbi bazat e të dhënave përkatëve. **(1 pikë)**

2. Vetë-interesi është një nga pesë kërcënimet etike ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore dhe pavarësinë në auditim.

- a) Përmendni shkurtimisht katër shembuj praktikë sesi mund të shfaqet rreziku i vetë-interesit. **(2 pikë)**
- b) Përmendni shkurtimisht katër masa mbrojtëse ndaj interest financiar në një klient auditimi. **(2 pikë)**

Zgjidhje:

Sipas SNKC1, një shoqëri auditimi duhet të vendosë politika dhe procedura që synojnë ta pajisin atë me sigurinë e arsyeshme se firma dhe personeli i saj vepronë në pajtim me kërkesat përkatëse etike. Në përputhje me SNKC1, shoqëria duhet të identifikojë dhe vlerësojë rrethanat dhe marrëdhëniet që krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë dhe të ndërmarrë veprimet e duhura për t'i eliminuar këto kërcënime, ose për t'i zvogëluar ato në një nivel të pranueshëm, përmes zbatimit të masave mbrojtëse,

ose nëse gjykohet e nevojshme, për t`u tërhequr nga angazhimi, kur tërheqja është e mundur sipas ligjeve dhe rregullave të zbatueshme. Vetë interesi (interesi personal) përbën një nga këto kërcënime.

- a. Shëmbujt e mëposhtëm ilustrojnë disa nga format sesi mund të shfaqet rreziku i vetë interesit gjatë auditimit, duke përbërë kërcënim të objektivitetit dhe pavarësisë:
- Vartësia nga klienti për shkak të nivelit të tarifave të auditimit të aplikuara ndaj tij, sidomos kur këto përfaqësojnë një vlerë të rëndësishme ndaj totalit të të ardhurave;
 - Tarifat e papaguara dhe të prapambetura të auditimeve të viteve të mëparshme, në kushtet kur shoqëria e auditimit ka vijuar marrëdhënien me klientin;
 - Kur i audituesit i ofrohen tarifa shtesë të auditimit që varen edhe nga performanca e biznesit të klientit, për shembull, nga fitimi përpara tatimit;
 - Ofrimi dhe pranimi i komisioneve nga klienti;
 - Angazhimi afatgjatë me klient dhe ofrimi i shërbimit të auditimit për një periudhë të gjatë kohe;
 - Angazhimi i stafit të auditimit në mënyrë të përkohëshme në pozicione të brendshme të klientit të auditimit, me rol vendimarrës ose në role kyç në raportimin e financiar;
 - Ofrimi i shërbimeve të rekrutimit nga ana e shoqërisë së auditimit, për pozicione kyçe në klientin ekzistues të auditimit, përfshirë këtu pozicione si drejtues finance etj;
 - Dhënia e huasë për klientin apo marrje e huasë nga klienti;
 - Pranimi i nxitjeve, përfshirë dhuratat dhe mikpritjen.

Kandidati mund të propozojë shembuj të tjerë relevantë dhe të ndryshëm nga sa më sipër. Çdo shembull i saktë i propozuar nga kandidati vlerësohet me 0.5 pikë, për një total 2 pikë.

- b. Disa nga masat mbrojtëse ndaj interesit financiar në një klient auditimi përfshijnë:
- Eliminimi i interesit, për shembull, duke u dorëhequr si auditues nga një klient i cili ka detyrime të papaguara;
 - Heqja nga ekipi i auditimit të një klienti, të një auditues anëtar të ekipit, i cili që shkakton një interes financiar për shkak të marrëdhënies direkte personale me këtë klient;
 - Informimi i komitetit të auditimit të klientit për situatën;
 - Rishikimi i punës së auditimit nga ortaku i pavarur të kontrollit të cilësisë.

Çdo shembull i saktë vlerësohet me 0.5 pikë, për një total 2 pikë.

3. Çfarë duhet të arrijë të njohë ekipi i angazhimit të grupit nga audituesi i entitetit të kontrolluar, nëse ekipi i angazhimit të grupit vendos se do të marrë siguri nga audituesi i entitetit të kontrolluar për të kryer punë mbi informacionin financiar të entitetit të kontrolluar?

Po në rast se nuk arrin të njohë audituesin e entitetit të kontrolluar çfarë duhet të bëjë ekipi i angazhimit të grupit?

Zgjidhje:

(2 pike)

- a) Nëse audituesi i entitetit të kontrolluar njihet dhe i plotëson kërkesat etike që kanë lidhje me auditimin e grupit dhe në veçanti, është i pavarur.
- b) Kompetencën profesionale të audituesit të entitetit të kontrolluar.

- c) Nëse ekipi i angazhimit të grupit do të jetë në gjendje të përfshihet në punën e audituesit të entitetit të kontrolluar në masën e nevojshme për të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme e të përshtatshme.
- d) Nëse audituesi i entitetit të kontrolluar vepron në një mjedis rregullator që mbikëqyr audituesit në mënyrë aktive.

(2 pike)

Nëse një auditues i entitetit të kontrolluar nuk i plotëson kërkesat për pavarësi, të cilat kanë të bëjnë me auditimin e grupit apo ekipi i angazhimit të grupit ka shqetësime serioze në lidhje me çështje të tjera të listuara në pikat (a) - (c) me sipër, atëherë ekipi do të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme e të përshtatshme për informacionin financiar të këtij entiteti, pa kërkuar që audituesi të kryejë punë mbi informacionin financiar të tij.

4. Cilat janë kufizimet/te metat e auditimit dhe materialitetit?

Zgjidhje:

- Auditimi nuk është objektiv. Për të kryer auditimin duhet të behen gjykime të tilla si: sa mostra nga popullata do të testohen, çfarë të testojme për vlerësimin e rreziqeve, cilat gabime janë perfaqesuese etj. (0.57 pike)
- Jo të gjithë zerrat e pasqyrave financiare testohen. Audituesi duhet të zgjedh, bazuar në gjykim, se çfarë të testojë duke patur kështu rrezik të perzgjedhjes së mostrave. (0.57 pike)
- Raporti i auditimit leshohet kohe pas dates së pasqyrave financiare. Kjo bën që pozicioni aktual dhe pozicioni historik që auditohet të jenë ndryshe. (0.57 pike)
- Evidencat e auditimit ndonjëherë tregojnë se çfarë është e mundshme, jo se çfarë është e sigurt, të tilla si gjykimet e perdorura, vlerësimet dhe qellimet. (0.57 pike)
- Vet sistemi I kontabilitetit dhe kontrollit mund të ketë kufizime marre parasysh: gabimet njëzore, mundësinë e marreveshjeve për mashtrim, mundësia që kontrollet anashkalohen nga drejtimi, për transaksionet jo-rutine etj.(0.57 pike)
- Raporti i auditimit ka kufizime të qenesishme të tilla si: formati standard, personat pa njohur në fushën e auditimit mund të kenë veshitësi për të kuptuar gjuhën e përdorur në raportin e auditimit etj. (0.57 pike)
- Materialiteti bazohet në gjykimin e audituesit, prandaj, mund të ketë ndryshim gjykimi dhe shans gabimi gjatë marrjes së vendimit në lidhje me materialitetin e informacionit. (0.57 pike)

5. Çfarë tregon: a). Paragraf që Thekson Çështje; dhe b) Paragraf për Çështje të Tjera me konteksim e SNA 706?

Zgjidhje:

(2 pike)

- a) Paragraf që Thekson Çështje – një paragraf që përfshihet në raportin e audituesit, i cili i referohet një çështjeje të paraqitur ose të shpjeguar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare, e cila sipas gjyimit të audituesit është me shumë rëndësi, pasi është thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare nga ana e përdoruesve.

(2 pike)

- b) Paragraf për Çështje të Tjera – një paragraf që përfshihet në raportin e audituesit, i cili shërben për të referuar një çështje tjetër të ndryshme nga ato që janë paraqitur në pasqyrat financiare

dhe që sipas gjykimit të audituesit është e rëndësishme për kuptimin nga ana e përdoruesve të auditimit, të përgjegjësive të audituesit ose të raportit të audituesit.

6. Shpjegoni se si situatat e mëposhtme do të ndikojnë në raportin e auditimit dhe opinionin e auditimit:

- Pasqyrat financiare të një klienti nuk përmbajnë pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare
- Një klient ka hapur ndaj shoqërisë një çështje gjyqësore. Kjo çështje është shpjeguar në shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare por nuk është provizionuar asnjë shpenzime gjyqësor apo kompensim ndaj klientit, duke qenë se këto shuma nuk mund të maten me saktësi e arsyeshme. Administratori ka marrë konsulence ligjore sipas të ciles padia mund të mbrohet me sukses.

Zgjidhje:

- Nëse klienti nuk e ka të detyrueshme përgatitjen e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare, sipas kuadrit përkatës raportues, atëherë mungesa e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare nuk do të ketë ndonjë ndikim në opinionin apo raportin e auditimit. (0.5 pike)
- Nëse klienti e ka të detyrueshme përgatitjen e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare, sipas kuadrit përkatës raportues, pasqyrat e tij financiare duhet të përmbajnë edhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare. Për këtë arsye opinionin e audituesit duhet të jetë i kualifikuar, duke qenë se pasqyrat financiare janë me anomali në mënyrë materiale. Çështja nuk është e përhapur, kufizohet vetëm të pasqyra e flukseve të mjeteve monetare. (1 pike)

Paragrafi mbi bazën e opinionit të kualifikuar do të referohet faktit se pasqyrat financiare nuk përmbajnë pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare dhe do të përfshijë vlerat e kerkuara. Paragrafi i opinionit do të pohojë se pasqyra financiare paraqesin një pamje të vertetë dhe të drejtë dhe janë përgatitur, në të gjitha aspektet material, në përputhje me kuadrin financiar të aplikueshëm, përveç mungesës së pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare. (0.5 pike)

- Në këtë rast audituesi duhet të përcaktojë nëse çështja gjyqësore është materiale dhe nëse është e përhapur në pasqyrat financiare në teresi. Për shembull, nëse padia është nga një klient kyc, kjo mund të ketë një efekt të pafavorshëm që mund të prek vijimesinë e shoqërisë. (0.5 pike)
- Nga të dhënat kemi se shenimet shpjeguese janë dhënë në mënyrë të pershtatshme dhe nuk ka arsye për të provizionuar ndonjë shpenzim. Sidoqoftë, raporti i audituesit do të modifikohet, nga fakti që ka një pasiguri e cila mund të prek biznesin. Audituesi duhet të vendosë nëse pasiguria e genesishme është thelbësore për përdoruesit e pasqyrave financiare. (0.5 pike)
- Nëse është thelbësore, atëherë në raportin e audituesit duhet të shtohet një paragraf theksim çështje, poshtë paragrafit të opinionit i cili do të përmbajë detaje në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu duhet pohuar se opinionin e audituesit nuk modifikohet në lidhje me këtë çështje. (1 pike).

7. Nëse do të ishit duke audituar një klient në industrinë financiare çfarë informacioni dhe kuptueshmëri do të dokumentoni në dosjen tuaj për sa i përket ligjeve dhe rregulloreve në fuqi (SNA250).

Zgjidhje:

Efekti në pasqyrat financiare i ligjeve dhe rregullave ndryshon shumë. Këto ligje dhe rregulla, të cilëve ju nënshtrohet entiteti, përbëjnë edhe kuadrin ligjor dhe rregullator. Dispozitat e disa ligjeve apo rregullave kanë një efekt të drejtpërdrejtë mbi pasqyrat financiare për faktin që ato përcaktojnë shumat që raportohen apo informacionet që jepen në pasqyrat financiare të një entiteti. Disa ligje apo rregulla të tjera duhet të respektohen nga drejtimi, ose ato përmbajnë dispozita të cilat drejtojnë kryerjen e aktivitetit të tij, por nuk kanë një efekt të drejtpërdrejtë mbi pasqyrat financiare. Disa entitete veprojnë në sektorë mjaft të rregulluar (siç janë bankat dhe shoqëritë kimike). Audituesi bën dallimin e përgjegjësisë së audituesit në lidhje me pajtueshmërinë në dy kategori të ndryshme të ligjeve dhe rregullave:

1. Dispozitat e atyre ligjeve dhe rregullave, që përgjithësisht njihen se kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e shumave materiale dhe informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare, si për shembull ligjet dhe rregullat fiskale dhe ato të sigurimeve shoqërore
2. Ligje dhe rregulla të tjera të cilët nuk kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e shumave materiale dhe informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare, por respektimi i të cilëve mund të jetë themelor për aspektet e veprimtarive të shfrytëzimit të entitetit, për një aftësi të tij për të vazhduar biznesin, apo për të shmangur penalitetet materiale (p.sh., respektimi i afateve të një licensë të shfrytëzimit, respektimi i rregullave në aspektin e aftësive paguese apo në aspektet ambientale); papajtueshmëria me këto ligje dhe rregulla mund të ketë një efekt material në pasqyrat financiare

Si pjesë e njohjes së entitetit dhe të mjedisit të tij sipas SNA 315 audituesi duhet të sigurojë një njohje të përgjithshme për:

- (a) Kuadrin ligjor dhe rregullat të cilave i nënshtrohet entiteti dhe sektori në të cilin ai vepron; dhe
- (b) Mënyrën se si entiteti e respekton këtë kuadër
- (c) Audituesi duhet të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me pajtueshmërinë me dispozitat e këtyre ligjeve dhe rregullave, të cilët janë përgjithësisht të njohura se kanë një efekt të drejtpërdrejtë në përcaktimin e shumave dhe informacioneve në pasqyrat financiare

Ne kuader të pikes a me lart, audituesi duhet të sigurojë një njohje të rregulloreve të Bankes së Shqipërisë për industrinë financiare në përgjithësi dhe për sektorin me specifik si psh banka, shoqëri financiare jo-bankare, etj.

Për të identifikuar rastet e papajtueshmërisë me ligjet dhe rregullat, të cilat mund të kenë efekte materiale në pasqyrat financiare, audituesi duhet të zbatojë procedurat e mëposhtme:

- a) T'i kërkojë drejtimit, dhe kur është e përshtatshme, personave të ngarkuar me qeverisjen, që të deklarojnë nëse entiteti është në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat;
- b) Të inspektojë korrespondencën me autoritetet përgjegjëse të licensimit ose autoritetet rregullatore, nëse kjo korrespondencë ekziston

8. “Audituesi duhet që jo vetëm të jetë i pavarur por edhe të jetë e dukshme që është i pavarur”. Komentoni shprehjen me sipër duke komentuar në lidhje me pavaresinë e mendjes (2 pike) dhe pavaresinë në dukje (2 pike).

Zgjidhje:

Pavaresia e mendjes: gjendja mendore që lejon dhenien e një opinioni pa u prekur nga ndikimet që komprometojnë gjykimin profesional, duke lejuar një individ të veprojë me integritet dhe të ushtrojë objektivitetin dhe skepticizëm profesional.

Pavaresia në dukje: shmangia e fakteve dhe rrethanave që janë aq të rëndësishme sa që një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, që ka njohuri për të gjithë informacionin përkatës, duke përfshirë masat mbrojtëse të zbatuara, do të konkludonte në mënyrë të arsyeshme se integriteti, objektiviteti ose skepticizmi profesional i një firme ose një anëtari të ekipit të auditimit është komprometuar.

9. Cilat janë procedurat që parashikon ligji nr 10091 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” për emerimin e audituesve ligjor dhe shoqërive të auditimit? A ka sanksione në lidhje me emerimin e audituesit ligjor? Nëse po, cilat janë ato?

Zgjidhje:

Audituesi ligjor ose shoqëria audituese emërohet çdo vit, nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve, për shoqëritë aksionare, ose nga asambleja e ortakëve, për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. (0.5 pike)

Shoqëritë tregtare, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, të këtij ligji, janë të detyruara të emërojnë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të tyre, të paktën, një shoqëri auditimi, që ka të regjistruar jo më pak se dy auditues ligjorë; ose dy auditues ligjorë, persona fizikë; një auditues ligjor person fizik dhe një shoqëri auditimi, që ka të regjistruar, të paktën, një auditues ligjor; apo dy shoqëri auditimi, që kanë të regjistruar, përkatësisht, vetëm një auditues ligjor. (0.5 pike)

Procedurat e emërimit të audituesit ligjor apo shoqërisë audituese përcaktohen, sipas rastit, nga rregullat për qeverisjen e shoqërive tregtare, nga ligjet përkatëse, kur shoqëritë veprojnë në sektorë të rregulluar, ose nga autoritetet e mbikëqyrjes së tyre apo aktet që rregullojnë funksionimin e tyre. (0.5 pike)

Audituesi ligjor, që është person fizik dhe audituesi ligjor apo ortaku kryesor në një shoqëri audituese, që është audituesi ligjor përgjegjës për kryerjen e auditimit, në emër të shoqërisë së auditimit, duhet të zëvendësohet për kryerjen e auditimit brenda një periudhe maksimale prej 7 vjetësh nga data e caktimit si auditues ligjor dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e shoqërisë pas mbarimit të një afati kohor prej, të paktën, dy vjetësh. (0.5 pike)

Në rast se marrja përsipër e misionit të auditimit është bërë pa respektuar procedurat e emërimit të audituesit, të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji, si dhe nga rregullat e auditimit apo nga statuti; sanksioni për këtë shkelje është pezullim i përkohshëm, për një kohë jo më shumë se pesë vjet. (1 pike)

Gjithashtu, nga ana tjetër, nëse marrja përsipër e misionit të auditimit është bërë pa respektuar procedurat e emërimit të audituesit, të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji, atëherë auditimi nuk mund të quhet në përputhje me ligjin, si pasojë e dhenisë së opinionit nuk ka vlerë ligjore duke bërë kështu opinionin e dhënë të gabuar. (1 pike)

10. a) Pershkruani se cfare kuptoni me kompetence profesionale duke dhene dhe shembuj te aftesive, ne lidhje me kompetencen profesionale, qe nje auditues duhet te kete.

b) Diskutoni mbi situataten e meposhtme ne konteksin e pavaresise se audituesit, duke treguar dhe parimet e perfshira:

Manaxheri i auditimit zoteron 1% te aksioneve te nje klienti auditimi. Partneri i angazhimit nuk zoteron ndonje aksion te klientit te auditimit.

Zgjidhje:

a) Kompetenca i referohet aftësisë së demonstruar për të kryer role ose detyra përkatëse sipas standardit të kërkuar. Pra, kompetenca i referohet demonstrimit aktual të performancës. Kompetenca mund të vlerësohet me një larmi mjetesh, përfshirë performancën në vendin e punës, simulimet në vendin e punës, testet me shkrim dhe me gojë të llojeve të ndryshme dhe vetëvlerësimin. Per kete audituesi duhet te zoteroje nje sere aftesish dhe vetem audituesit e kualifikuar ne menyren e duhur njihen si kompetent per te mbajtur titullin e audituesit. Disa shembuj te aftesive, ne lidhje me kompetencen, qe nje auditues duhet te zoteroje:

- Aftesia per te kuptuar objektivat e auditimit
 - Aftesia per te komunikuar ne menyren e duhur me pale te tjera
 - Aftesia per te interpretuar sisteme - Aftesia per te sfiduar drejtimin dhe status quo e krijuar
- (2 pike)

b) Partneri I auditimit nuk ka aksioni te klientit, keshtu qe mund te shihet se opinionin i auditimit do te jete objektiv. Sidoqofte, manaxheri i auditimit ka aksione te klienti, edhe pse jo materiale per klientin e auditimit (1% te aksioneve), kjo mund te jete materiale per manaxherin e auditimit dhe mund te shihet se kjo do te ndikojte aftesine e tij per te dhene nje opinion te paanshem ne lidhje me klientin. Duke qene se partneri i angazhimit do te mbeshetet ne menyre te pashmangshme mbi punen e plotesuar dhe kontrolluar nga manaxheri i auditimit, dhe duke qene se manaxheri i auditimit mund te jete i ndikuar nga interesi financiar ne punen e kryer, kjo to te conte ne dhenien e nje opinionin jo objektiv. Manaxheri i auditimit duhet te mos jete pjese e skuadres se auditimit ose duhet te shes aksionet qe zoteron te klienti i auditimit. (2 pike)

USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)

Ushtrimi 1

Shoqëria juaj e auditimit është emëruar edhe këtë vit për auditimin e pasqyrave financiar të klientit Marea Shpk për vitin e mbyllur më 31 dhjetor. Marea Shpk është një shoqëri tregtare me interes publik që zbaton Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Me përfundimin e auditimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021, F.T., ortaku kryesor i auditimit do të ketë vepruar për shtatë vjet në këtë rol. Ai e ka të qartë që duke patur parasysh që klienti Marea Shpk është një njësi ekonomike me interes publik, ai do të duhet të tërhiqet dhe një një partner i ri i auditimit duhet të zë vendin e tij. F.T. shpreson të qëndrojë në kontakt me klientin duke vepruar si kontrollor i cilësisë së angazhimit në auditimet e ardhshme të Marea Shpk.

Kërkohet:

Shpjegoni kërcënimet etike dhe masat mbrojtëse përkatëse që do të zbatohen në rastin e mësipërm, dhe diskutoni nëse F.T. mund të veprojë si rishikues i kontrollit të cilësisë së angazhimit në auditimet e ardhshme të Marea Shpk.

Zgjidhje:

Kërcënimi etik i mundshëm në rastin konkret është ai i **familjaritetit**. Kërcënimi i familjaritetit mund të ndodhë si rezultat i marrëdhënies së ngushtë që mund të jetë zhvilluar ndërmjet F.T., si ortak angazhimi, dhe drejtimit të klientit Marea Shpk. Për më të për që F.T., që është personel i lartë për këtë auditim (pra ortak angazhimi) dhe është angazhuar në këtë klient për një periudhe kohe të gjatë.

(1 pikë për identifikimin e saktë të kërcënimit etik)

Sipas SNKC1, referuar gjithashtu dhe Kodit të BSNEK, kërcënimi i familjaritetit, që për të rrezik të mundshëm ndaj pavarësisë, duhet të vlerësohet me kujdes dhe në këtë rast do të varet nga faktorë të tillë si:

- i) Niveli i senioritetit të auditorit. (F.T. është ortak kryesor i angazhimit, pra ka nivel të lartë dhe si i tillë mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm);
- ii) Kohëzgjatja e marrëdhënies me klientin dhe e përfshirjes së shërbimit të audituesit të lartë në angazhim (shtatë vjet është një kohë e konsiderueshme);
- iii) Natyra e klientit (në këtë rast është një klient me interes publik).

(1 pikë për shpjegimin të arsyes të kërcënimit etik)

SNKC 1 në përputhje me kërkesat e Kodit të BSNEK kërkon që shoqëria e auditimit të kryejë **vlerësimin e nevojës për masat mbrojtëse** që do të shërbejnë për pakësimin e rrezikut të familjaritetit në një nivel të pranueshëm, në rastet kur përdoret i njëjti personel i lartë/ kryesor në një angazhim të dhënies së sigurisë për një periudhë kohe të gjatë, siç është në rastin konkret.

Masat mbrojtëse përkatëse të cilat mund të ndihmojnë në pakësimin e këtij kërcënimi mund të përfshijnë:

- Rotacionin e personelit të lartë, pra në këtë rast të ortakut të angazhimit F.T., për një periudhë jo më shumë se shtatë vjet. **(0.5 pikë)**
- Rishikime të rregullta të kontrollit të cilësisë nga një partner i pavarur. **(0.5 pikë)**

F.T. nuk mund të veprojë si rishikues për kontrollin e cilësisë së angazhimit, sepse sipas SNKC1 referuar Kodit të Etikës të BSNEK, kërkesa për rotacion përjashton çdo kontakt me subjektin e audituar gjatë periudhës dy vjeçare. **(1 pikë)**

Gjithashtu, Marea Shpk është një entitet me **interes publik**. Ortaku i angazhimit duhet të ndërrohet pas **shtatë vjetësh** dhe nuk mund të përfshihet më në auditimin e klientit për një periudhë para mbarimit të një afati kohor prej, të paktën, **dy vjetësh** duke marrë kështu një periudhë 'ftohjeje'. **(1 pikë)**

Ushtrimi 2

Ju jeni menaxher auditimi pranë PiK Auditors Shpk. Së fundmi juve jeni bërë përgjegjës për rishikimin e faturave ndaj klientëve të PiK Auditors Shpk dhe pagesat përkatëse, si dhe për monitorimin e procedurave të kontrollit të kredisë të firmës suaj. Gjatë shqyrtimit tuaj më të fundit të faturave ndaj klientëve, ju identifikuar se, Norea Shpk, një shoqëri e madhe private dhe klienti i firmës tuaj, nuk ka paguar një faturë nga PiK të datës 12 shkurt 2020, për punën në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Një email i datës 26 nëntor 2020 lidhur me faturën e prapambetur, dërguar nga drejtori i financës së klientit, thotë se Norea Shpk ka vështirësi likuiditeti dhe se aktualisht nuk është në gjendje të paguajë detyrimet ndaj kreditorëve. Ky është informacioni i vetëm që keni në lidhje me faturën. Ju jeni në dijeni gjithashtu se puna përfundimtare e auditimit të rradhës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 nuk ka përfunduar ende tërësisht, por shërbimi është faturuar gati i plotë dhe raporti i auditorit pritet të lëshohet menjëherë në ditët në vijim. Sot është 17 mars 2021.

Kërkohet

Identifikoni dhe diskutoni çështjet etike dhe çështje të tjera profesionale të ngritura nga rishikimi i dosjes së faturave, dhe rekomandoni çfarë veprimi, nëse ka të tilla, firma duhet të ndërmarrë në lidhje me rastin në fjalë.

Zgjidhje:

Kërcënimi ndaj pavarësisë

Një nga çështjet etike dhe profesionale është ajo e kërcënimit të mundshëm ndaj **pavarësisë** që lidhet më pagesën e vonuar për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2019, sipas faturës së datës 12 shkurt 2020. Si pasojë e vonës në pagesën e tarifës së auditimit për një periudhë mbi 12 muaj, mund të lindë një kërcënim i **interesit personal (vetë-interesi)** dhe të kërcënohet kështu pavarësia e audituesit. Për më tepër në kushtet kur PiK Auditors Shpk ka vijuar me klientin duke ndërmarrë angazhimin për auditimin e rradhës për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2020. **(1 pikë)**

Masat e mundshme

PiK Auditors Shpk duhet të diskutojë për rikuperueshmërinë e tarifës së auditimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 me komitetin e auditimit të klientit (nëse ekziston një i tillë), ose me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen. Më pas PiK Auditors Shpk duhet të vlerësojë së brendshmi situatën. Shoqëria mundet të vijojë si auditues i Norea Shpk me kusht që të ekzistojnë masat mbrojtëse të përshtashme dhe shuma e papaguar nuk është e rëndësishme, pra ajo nuk është materiale. Nëse tarifat e pa paguara janë të konsiderueshme dhe PiK Auditors Shpk nuk mund të marrë masa për të eliminuar kërcënimet ndaj objektivitetit dhe pavarësisë ose t'i zvogëlojë ato në një masë të pranueshme, sidomos në kushtet kur kryerja e pagesës nuk shihet si e mundur, shoqëria duhet të konsiderojë dorëheqjen si auditues. **(1 pikë)**

Kërcënim të interesit personal (vetë-interesit)

Raporti i audituesit të pavarur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 nuk është nënshkruar ende nga ana e shoqërisë PiK Auditors Shpk. Kjo krijon një kërcënim të interesit personal (vetë-interesit). Objektiviteti dhe pavarësia e audituesit është e kërcënuar sepse audituesi mund të synojë të lëshojë një raport të pamodifikuar i cili mund të rrisë probabilitetin për pagesën e prapambetur. **(1 pikë)**

Masat e mundshme

Opinioni i audituesit të pavarur së bashku me letrat e punës të prodhuara nga angazhimi duhet të jenë subjekt rishikimi nga ana e partnerit rishikues të kontrollit të cilësisë së angazhimit. **(1 pikë)**

Vijueshmëria e biznesit.

Mospagesa e faturës së për shërbimin e auditimit çon në dyshime lidhur me vijueshmërinë e biznesit për shkak të problemeve të likuiditetit dhe flukseve monetare të parasë. Kjo do të thotë që nëse një dyshim i tillë qëndron, ai duhet adresuar në mënyrën e duhur në opinionin e audituesit të pavarur për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. **(1 pikë)**

Ushtrimi 3

Ju jeni duke kryer auditimin e një shoqërie hidrokarburesh. Gjate shpimeve të tyre ndodhi një aksident dhe si pasojë e shpimeve ujesjellesi i qytetit u ndot me naftë. Te gjithë banoret e qytetit, përfshirë edhe bashkinë, kanë kërcënuar se do të bëjnë padi kundër shoqërisë, përveçse nëse ajo arrin të kompensojë dëmet e shkaktuara dhe të paguajë për shqetësimin që ka krijuar. Shoqëria ka llogaritur një provision në lidhje me këtë padi të mundshme.

Ju si auditues, identifikoni dhe shpjegoni se çfarë informacioni shtesë ju nevojitet për të marrë evidence auditimit për këtë provizion.

Zgjidhje:

Informacioni shtesë që do të duhet si evidence auditimi në lidhje me provizionin është:

- Data kur ka ndodhur aksidenti, që supozohet që duhet të ketë ndodhur duke qenë se shoqëria ka llogaritur provision (provizionin mund të krijohet vetëm nëse ka një detyrim aktual i cili ka ardhur si pasojë e ngjarjeve të kaluara) (1 pikë)
- Probabiliteti që ka shoqëria për të kompensuar banoret dhe bashkinë. Nëse ka të ngjarë që shoqëria të fitojë gjyqin, atëherë nuk ka pse të krijohet provision. (1 pikë)
- Numri i banoreve të dëmtuar dhe kosto e kompensimit të tyre si dhe dëmet e shkaktuara bashkë dhe kosto e kompensimit të tyre (1 pikë)
- Vlera shtesë e pagesës, përtej dëmit, për të paguar banoret për shqetësimin e krijuar (1 pikë)
- Nëse shoqëria ka pësuar ndonjë dëm në pajisjet e perdorura për nxjerrjen e hidrokarbureve si rezultat i aksidentit dhe kosto e riparimit të tyre. (1 pikë)

Ushtrimi 4

Shoqëria Hidra shpk, ka patur një humbje neto prej 30 milion Leke për fund vitin 31 dhjetor 2020, shifër kjo e cila është materiale. Po ashtu detyrimet e saj financiare afatshkurtra kalojnë aktivet financiare afatshkurtra me 60 milion Leke më 31.12.2020. Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose

kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë sipas SNA 570.

Drejtimi i Shoqërisë Hidra shpk ka bërë shpalosjet në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me SNRF, të duhura në Shënimin 6, në dhe audituesi gjykon se shpalosja e pasigurisë materiale është e përshtatshme. Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar.

Ilustroni me një shembull konkret si do të ishte raporti i audituesit në këtë rast, duke përfshirë paragrafin e opinionit, bazës për opinion, paragrafë të tjerë, por pa përfshirë paragrafët mbi përgjegjësit e drejtimit dhe të audituesit.

Zgjidhje:

Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë sipas SNA 570 (i rishikuar). Paraqitja në pasqyrat financiare e pasigurisë materiale është e përshtatshme.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Hidra shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31 Dhjetor 2020, dhe pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të Shoqërisë në datën 31 Dhjetor 2020, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me SNRF.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me SNA. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Pasiguria Materiale në Lidhje me Vijueshmërinë

Ne tërheqim vëmendjen tek Shënimi 6 në pasqyrat financiare, i cili tregon se kompania pati një humbje neto prej 30 milion Leke gjatë vitit që përfundon me datë 31 Dhjetor 2020 dhe nga ajo datë, detyrimet afatshkurtra të Shoqërisë tejkalojnë totalin e aktiveve me 60 milion Leke. Siç është përshkruar në Shënimin 6, këto ngjarje ose rrethana, së bashku me çështje të tjera të përcaktuara në Shënimin 6, tregojnë se ekziston një pasiguri materiale që mund të krijojë dyshime të mëdha lidhur me aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Opinioni ynë nuk është i modifikuar lidhur me këtë çështje.

Ushtrimi 5

Juve si auditues, ju ofrohet nje klient auditimi, administrator I te cilit ju kerkon qe vetem auditimi i vitit te pare te kryhet me gjysmen e tarifes qe ju aplikoni. Audituesi ekzistues ka nje kontrate 3 vjecare me klientin dhe nuk ka dhene doreheqje, por administrator I klientit ju njofton se ai nuk do te riemerohet ne te ardhmen.

- a) Cfare veprime duhet te ndermerrni ju si auditues ne lidhje me kerkesen e administratorit te klientit per te ulur tarifen e auditimit vitin e pare ne 50% te tarifes qe ju aplikoni?
- b) A ka te drejte audituesi i meparshem te mos dorehiqet, duke e ditur qe administratori i klientit deshiron ta zevendesoje ate? Arsyetoni pergjigjen tuaj.

Zgjidhje:

a) Kerkesa e administratorit te klientit per te pergjysmuar tarifen e auditimit eshte e papershtatshme. Nese ne si auditues do ta prananim kete propozim, atehere mund te ishim ne shkelje te kodit te etikes pasi mund te krijohej nje kercenim ndaj pavaresise dhe objektiviteit pasi do te kerkonim te siguronim pune permes kuotimit te tarifave me te ulta. Kjo nuk do te ishte etike dhe mund te rezultojte ne masa disiplinore ndaj audituesit. Administratori i klientit duhet te informohet se tarifa e auditimit do te vendoset merr parasysh punen e kerkuar per te permbushur ne menyre te kenaqshme procedurat e auditimit, marre parasysh naturen dhe detyrat e auditimit te perfshira si dhe burimet e kerkuara per te kryer keto procedura ne nje menyre eficente. Gjithashtu administratori i klientit duhet te informohet se nese klienti nuk eshte pergatitur per te pranuar nje tarife auditimi te perlllogaritur si me lart atehere ju nuk do te pranoni te emeroheni auditues i ketij klienti. (2.5 pike)

b) Audituesi ekzistues ka cdo te drejte per te mos dhene doreheqje nga auditimi i klientit, edhe duke e ditur qe administratori i klientit do ta zevendesoje ate. Audituesit emerohen dhe raportojne te asambleja e ortakeve/aksionareve dhe administratori nuk ka fuqi ligjore per ti zevendesuar ata. Nese lind nje arsye per zevendesimin e audituesit per shkak te mosmarreshjeve midis administratorit dhe audituesit, atehere audituesi ka te drejte te shpalos pikepamjet e tij dhe te insistojte qe vendimi duhet marre nga ortaket/aksionaret vetem pasi at ate behen te ditur ne lidhje me faktet e mosmarreshjes se lindur mes administratorit dhe audituesit. (2.5 pike)

Ushtrimi 6

Shpjegoni termin “Due diligence/ kujdesi i duhur” dhe identifikoni disa shembuj praktik te ketij lloj angazhimi.

Zgjidhje:

Due diligence/kujdesi i duhur, jane rishikime specifike. Nje angazhim due diligence tipik eshte kur konsulenti (shpesh here nje firme auditimi), angazhohet nga nje kompani kur ajo planifikon te bleje nje kompani tjetere, dhe te beje vleresimin e rrezeve materiale te lidhura me kete transakcion per tu siguruar se bleresi behet i ditur me te gjitha faktet e nevojshme. Kjo eshte e rendesishme pasi ne baze te ketij rishimi mund te vendoset edhe cmimi i blerjes. Ne menyre te ngjashme, ky rishikim mund te kerkohet edhe nga shitesi. (2.5 pike)

Disa shembuj praktik te due diligence/kujdesit te duhur jane:

- Due diligence financiare- nje rishikim i pozicionit financiar dhe detyrimeve te shoqerise se synuar per tu blere per te identifikuar ceshtje te tilla si detyrimet kontigjente te marreveshjeve) (0.5 pike)
- Due diligence operacionale dhe te IT-se- shtrirja e rreziqeve operacionale dhe te IT-se, duke perfshire cilesine e sistemeve qe lidhen me shoqerine e synuar per tu blere) (0.5 pike)
- Due diligence per stafin- rishikimi I pozicioneve kyc sipas structures se re, kostot e perfundimit te kontrates dhe kostot e bashkimit(0.5 pike)
- Due diligence per rregullatoret- rishikimi I nivleit te pajtueshmerise se shoqerise se synuar per tu blere me rregullatoret perkates(0.5 pike)
- Due diligence mjedisore- ceshtjet mjedisore, shendestore dhe te sigurise dhe shoqerore ne nje shoqeri te synuar per tu blere(0.5 pike)

Ushtrimi 7

Ju jeni duke audituar pasqyrat financiare te vitit 2020 te nje rrjeti restorantesh. Jepen te dhenat me poshte:

| Treguesit | Viti 2020 | Viti 2019 |
|---|------------------|------------------|
| Te ardhurat nga sherbimi taksi | 200,000,000 Leke | 198,000,000 Leke |
| Te ardhurat nga sherbimi ne restorant | 2,800,000 Leke | 3,500,000 Leke |
| Fitimi para tatimit | 10,045,455 Leke | 11,853,637 Leke |
| Totali i aktiveve | 170,000,000 Leke | 119,000,000 Leke |
| Provizion per komepensimin e punonjesve te pushuar nga puna si rezultat i mbylljes se sherbimit taksi | 1,105,000 Leke | NA |

Ne dhjetor te vitit 2020 shoqeria beri te njohur planin per te mos e ofruar me sherbimin taksi, duke filluar nga fundi i muajit.

Komentoni ne lidhje me materialitetit, per ceshtjet me siper duke treguar dhe llogaritjet e mundshme.

Zgjidhje:

Sherbimi taksi

Sherbimi taksi eshte pjese e shitjeve totale te shoqerise, dhe treguesi I duhur per materialitetin e sherbimit taksi dot te jene te ardhurat nga sherbimi taksi.

Te ardhurat nga sherbimi taksi per vitin 2020 jane 1.4% e totalit te te ardhurave (2,800,000/202,800,000). Marre parasysh referencat e dhena ne standardet e auditimit ne lidhje me materialitetin, (Te ardhurat 0.5-1%), sherbimi taksi eshte material. (2 pike)

Provizion per komepensimin e punonjesve te pushuar nga puna si rezultat i mbylljes se sherbimit taksi

Matesi i duhur i materialitetit per provizionin do te jete totali i aktiveve dhe fitimi para tatimit, pasi provizioni prek te dy pasqyrat financiare (detyrimin e provizionin- Pasqyra e pozicioni financiar, shpenzimin e provizionit- Pasqyra e performances).

Provizioni eshte 0.65% e totalit te aktiveve (1,105,000/ 170,000,000). Marre parasysh referencat e dhena ne standardet e auditimit ne lidhje me materialitetin, (Totali i aktiveve 1-2%), provizioni nuk eshte material ne lidhje me pasqyren e pozicionit financiar.

Sidoqofte, provizioni eshte 11% e fitimit para tatimit (1,105,000/ 10,045,455). Marre parasysh referencat e dhena ne standardet e auditimit ne lidhje me materialitetin, (Fitimi para tatimit 5-10%), provizioni eshte material ne lidhje me pasqyren e performances. (3 pike)

Ushtrimi 8

SNA 315 "Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të gabimeve materiale përmes kuptimit të njësisë ekonomike dhe mjedisit të saj përcakton çështjet që duhet të dokumentohen në fazën e planifikimit të auditimit. Listoni pesë çështje që duhet të dokumentohen gjatë fazës së planifikimit.

Zgjidhje:

Ne kuadrin e kuptimit te Entiteti dhe Mjedisi i tij audituesi duhet të njohjë sa më poshtë:

- a) Sektorin e ekonomisë ku entiteti zhvillon aktivitetin e tij, kuadrin rregullator dhe faktorët e tjerë të jashtëm, përfshirë edhe kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
- b) Natyrën e entitetit, përfshirë:
 - (i) operacionet e tij;
 - (ii) strukturat e tij të drejtimit dhe qeverisjes;
 - (iii) llojet e investimeve që entiteti ka bërë ose planifikon të bëjë, përfshirë investimet në entitetet për qëllime të veçanta; dhe
 - (iv) mënyrën sesi është strukturuar dhe financohet entiteti, për të bërë të mundur që audituesi të kuptojë klasat e transaksioneve, tepricat e llogarisë dhe informacionet që pritet të jepen në pasqyrat financiare.
- c) Politikat kontabël që entiteti ka zgjedhur dhe zbatuar, së bashku me arsyet për ndryshime në to. Audituesi duhet të vlerësojë nëse politikat kontabël të entitetit janë në përshtatje me veprimtarinë e entitetit dhe në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe me politikat kontabël që përdoren në sektorin përkatës të ekonomisë.

- d) Objektivat dhe strategjitë e entitetit, dhe rreziqet përkatëse të veprimtarisë që mund të çojnë në rreziqe të anomalisë materiale.
- e) Matjen dhe rishikimin e performancës financiare të entitetit.

Ushtrimi 9

Cfare duhet te kete permbushur kandidati per auditues ligjor, përpara se të testohet në provimin përfundimtar për marrjen e titullit “Auditues ligjor”, me qëllim që të regjistrohet në regjistrin publik të audituesve ligjorë?

Zgjidhje:

Sipas ligjit 10091 date 5/3/2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te audituesit ligjor dhe te kontabilistit te miratuar” kandidati:

- a. duhet te kete permbushur të gjitha kërkesat e parashikuara në ligjin 10091 date 5/3/2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te audituesit ligjor dhe te kontabilistit te miratuar” për hyrjen në profesion; (1 pike)
- b. duhet te kete kaluar me sukses të gjitha testet e parashikuara në programin e përgatitjes profesionale; (1 pike)
- c. duhet te kete kryer gjysmën e praktikës profesionale, e cila zgjat në total 3 vjet, në kushtet e punësimit me kohë të plotë në auditimin e pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara ose pasqyrave financiare të tjera, të ngjashme, pranë një audituesi ligjor ose shoqërie auditimi të njohur në Republikën e Shqipërisë, që dallohet për reputacion të mirë dhe nën udhëheqjen e audituesve ligjorë që kanë garancitë e mjaftueshme për këtë qëllim.
Të paktën, dy të tretat e kësaj praktike profesionale duhet të kryhen pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie audituese, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë. (1 pike)
- d. Kandidati duhet të vërtetojë se gjatë praktikës profesionale me një auditues ligjor apo një shoqëri audituese ka kryer jo më pak se 600 orë pune në vit, si i angazhuar në auditimin ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara. (1 pike)
- e. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale kandidatët duhet të përmbushin detyrimet e praktikës profesionale dhe të punës, të thellojnë njohuritë profesionale, të jenë të bindur e të denjë për profesionin dhe t'i nënshtrohen çdo kontrolli nga ana e organizatës profesionale të audituesve ligjorë për punën e tyre. (1 pike)

Ushtrimi 10

Ju jeni audituesi ligjor i shoqërisë VBA sha për vitin 2020. Shoqëria kryen veprimtarinë e saj në tregun e sigurimeve. Manaxhimi i shoqërisë ju ka kërkuar të kryeni rishikimin e pasqyrave financiare për periudhën që mbyllet më 31 mars 2021.

Përcaktoni se mbi cilin standard të rishikimit do të planifikoni ta kryeni këtë angazhim si dhe cili është niveli i sigurisë që do ti ofroni shoqërisë në përputhje me procedurat që do të kryeni.

Listoni procedurat që planifikoni të kryeni për rishikimin e pasqyrave financiare për periudhën që mbyllet më 31 mars 2021.

Zgjidhje:

Meqënëse ju jeni audituesi ligjor i shoqërisë VBA sha për vitin 2020 atëherë standardi që ju duhet të zbatoni në kryerjen e angazhimit të rishikimit të pasqyrave financiare për periudhën që mbyllet më 31 mars 2021 është Standardi SNAR 2410, Rishikimi i Informacionit Financiar të Ndërmjetëm të Kryer nga Audituesit e Pavarur të Entitetit.

Në një angazhim rishikimi audituesi ligjor lëshon një opinion që jep më pak siguri se sa një opinion auditimi, pra nuk ofron siguri të arsyeshme, por siguri të kufizuar bazuar në procedurat e rishikimit që ai ka kryer.

Një rishikim bazohet kryesisht në pyetësorë dhe procedura analitike, se sa në procedura thelbësore për verifikimin e balancave dhe transaksioneve.

Në planifikimin e një rishikimi të pasqyrave financiare, praktikuesi duhet të marrë ose azhurnojë njohuritë e biznesit duke përfshirë shqyrtimin e organizatës së njësisë ekonomike, sistemet e kontabilitetit, karakteristikat e funksionimit dhe natyrën e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve të saj. Gjithashtu praktikuesi duhet të marrë ose azhurnojë njohuritë e biznesit duke vlerësuar nivelin e zbatimit dhe mjaftueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë. Këto procedura kryen mbi bazën e pyetësorëve me manaxhimin si dhe personelin përgjegjës për çështjet e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Gjithashtu, audituesi lexon minutat e mbledhjeve të bordit të shoqërisë, apo organeve të tjera vendimmarrëse.

Një nga procedurat kryesore është rishikimi i pasqyrave financiare për periudhën që mbyllet më 31 mars 2021 me atë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 për të identifikuar marrëdhëniet midis llogarive dhe ndonjë anomali midis tyre. Nëse evidentohen të tilla anomali, gjendjet e llogarive ose transaksioneve mund të kalojnë edhe në procedura të mëtejshme thelbësore.

Gjatë analizës së pasqyrave financiare për vitin 2020 audituesi duhet të verifikojë nëse çështjet që mund të kenë qënë bazë për opinion të modifikuar janë zgjidhur, apo aplikuar siç duhet në pasqyrat financiare të marsit 2021. I njëjti parim vlen edhe për mangësitë e identifikuara në kontrollet e brendshme, nëse ka të tilla.

Në procedurat analitike mbi pasqyrën e të ardhurave duhet të aplikohet krahasimi i të dhënave për 31 marsin 2021 me pasqyrën e të ardhurave për periudhën 31 mars 2020.

Meqënëse shoqëria është në një industri për të cilën ka informacion publik në lidhje me treguesit financiarë, të dhënat e tregut, të publikuara nga autoriteti mbikqyrës për këtë industri mund të përdoren si referencë për të evidentuar nëse ka ndonjë tregues në pasqyrat financiare të ndërmjetme të shoqërisë që mund të përmbajë gabime materiale.

Kur përdorni punë të kryer nga një praktikues tjetër ose një ekspert, audituesi duhet të jetë i kënaqur që një punë e tillë është e përshtatshme për qëllimet e rishikimit. I njëjti parim vlen edhe nëse gjatë rishikimit do të merrni në konsideratë punën e kryer nga audituesi i brendshëm i njësisë.

Audituesi duhet të zbatojë gjykimin në përcaktimin e natyrës specifike, kohës dhe masës së procedurave të rishikimit.

Audituesi duhet të zbatojë të njëjtat konsiderata të materialitetit, siç do të zbatoheshin nëse po jepet një opinion auditimi mbi pasqyrat financiare.

Audituesi duhet të hetojë në lidhje me ngjarjet pas datës së pasqyrave financiare që mund të kërkojnë rregullimin ose dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare.